



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK Nr. 04/2013 PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE TË ZYRTARËVE
POLICOR TË CILËT VDESIN NË DETYRË APO NË KRYERJE TË DETYRËS¹**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION GRK No. 04/2013 FOR DETERMINATION OF THE CASES OF
POLICE OFFICERS WHO DIE ON DUTY OR IN THE LINE DUTY²**

**ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA VRK Br. 04/2013 ZA UTVRÐSLUAJEVA POLICIJSKIH
SLUŽBENIKA KOJI SU POGINILI NA DUŽNOSTI ILI PO SLUŽBENOJ DUŽNOSTI³**

¹ Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për përcaktimin e rasteve të zyrtarëve policor të cilët vdesin në detyrë apo në kryerje të detyrës është miratuar në mbledhjen e 137 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr.01/137 me datë 03.07.2013.

² Administrative Instruction No. 04/2013 for determination of the cases of Police Officers who die on duty or in the line duty was approved on 137 meeting of the Government of the Republic of Kosovo with the decision No.01/137, date 03.07.2013.

³ Administrativnog Uputstva Br.03/2013 Br. 04/2013 za utvrđsluajeva Policijskih službenika koji su poginili na dužnosti ili po službenoj dužnosti osvojen je na 137 sednice Vlade Republike Kosova, odluku Br.01/137, od 03.07.2013.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Në pajtim me nenin 48 (5) të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , Nr. 04 datë 19.03.2012), dhe nenin 19 (6.2) të Rregullores Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV QRK Nr. 04/2013 PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE TË ZYRTARËVE POLICOR TË CILËT VDESIN NË DETYRË APO NË KRYERJE TË DETYRËS</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj rastet e zyrtarëve policor të cilët vdesin në detyrë apo në kryerje të detyrës.</p> <p>Neni 2 Fusha e zbatimit</p> <p>Dispozitat e këtij Udhëzimi administrativ zbatohen vetëm për zyrtarët policor të policisë së Republikës së Kosovës të cilët</p>	<p>Government of Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, In accordance with article 48(5) of the Law no. 04/L– 076 on Police (Official Gazette of the Republic of Kosovo, No. 04 of the date 19th of March 2012), and article 19 (6.2) of the Labour Regulation No. 09/2011 of the Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION GRK No. 04/2013 FOR DETERMINATION OF THE CASES OF POLICE OFFICERS WHO DIE ON DUTY OR IN THE LINE DUTY</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>This administrative instruction has the purpose to determine the cases of police officers who die on duty or in the line of duty.</p> <p>Article 2 Scope of application</p> <p>The provisions of this Administrative Instruction are applied only to police officers of the Kosovo Republic Police,</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosova, U skladu sa članom 48 (5) Zakona br. 04/L-076 za Policiju (Službeni glasnik Republike Kosova, br. 04 od 19.03.2012.) I član 19 (6.2) Uredbe br. 09 / 2011 za rad Vlade Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA VRK Br. 04/2013 ZA UTVRĐSLUAJEVA POLICIJSKIH SLUŽBENIKA KOJI SU POGINILI NA DUŽNOSTI ILI PO SLUŽBENOJ DUŽNOSTI</p> <p>Član 1 Svrha</p> <p>Ovo administrativno uputstvo ima za cilj da utvrdi slučajeve policajaca koji su poginuli na dužnosti ili po službenoj dužnosti.</p> <p>Član 2 Oblast primene</p> <p>Odredbe ove Direktive primenjuju se samo nad administrativnim službenicima policije Republike Kosovo koji su</p>
---	--	--

<p>vdesin në detyrë apo në kryerje të detyrës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin si në vijim:</p> <p>1.1. “Vdekja në Detyrë” Nënkupton vdekjen e zyrtarit policor i cili ka të themeluar marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës pavarësisht a është në vendin e punës apo jo.</p> <p>1.2. “Vdekja në kryerje të detyrës” nënkupton vdekjen e zyrtarit policor nga një akt kriminal, në operacionet policore apo aksident përgjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore derisa është në detyrë apo jashtë saj.</p> <p>1.3. “Anëtarët e familjes së ngushtë” nënkuptojmë, bashkëshortin/en, fëmijët martesor, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e birësuar dhe prindërit.</p> <p>2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin ashtu siç janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë.</p>	<p>who die on duty or in the line of duty.</p> <p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. The terms that are used in this Administrative Instruction have the following meaning:</p> <p>1.1. “Death on Duty” means the death of a police officer who has established working relations with the Kosovo Police, regardless if he is at his working place or not.</p> <p>1.2. “Death in the line of duty” means the death of a police officer from a criminal act in police operations or accident during the performance of the duties and police authorizations while on or out off duty.</p> <p>1.3. “Close family members” means husband\wife, marital children, extra marital children, adopted children and parents.</p> <p>2. Other terms that are used in this administrative instruction have the meaning as defined in Law on Police No.04/L-076.</p>	<p>poginuli na dužnosti ili po službenoj dužnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeća značenja :</p> <p>1.1. “Smrt na Dužnosti” smrt policajca koji je osnovao radni odnos u Kosovskoj policiji nezavisno toga da li je na poslu ili ne.</p> <p>1.2. “Smrt po službenoj dužnosti” znači smrt policajca od krivičnog dela ili nesreće tokom policijskih operacija ili prilikom obavljanju svojih dužnosti i ovlašćenja policije dok su na dužnosti ili van nje.</p> <p>1.3. “Članovi uže porodice” znaci, suprug/a, bracno dete, deca van braka, usvojena deca i roditelji.</p> <p>2. Ostali pojmovi upotrebljeni u ovom AU imaju značenje kao što je definisano u Zakonu za Policiju br. 04/L-076.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 4 Përcaktimi i rasteve të vdekjes së zyrtarëve</p> <p>1. Duke marrë parasysh kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarit policor të përcaktuar me legjislacionin përkatës në fuqi dhe duke u bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 04/L-076 për Policinë ekzistojnë dy kategori të vdekjes së zyrtarit policor:</p> <p>1.1. Vdekja e zyrtarit policor në detyrë dhe</p> <p>1.2. Vdekja e zyrtarit policor në kryerje të detyrës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Determination of the death cases of officials</p> <p>1. Taking under consideration competences and responsibilities of the police officers, determined by the relevant legislation in force and based on article 48 of the Law on Police No. 04/L-076, exist two categories of death of a police officer:</p> <p>1.1. Death of the police officer on duty and</p> <p>1.2. Death of the police officer in the line of duty.</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Utvrđivanje slucajeva smrti sluŹbenika</p> <p>1. S obzirom na ovlašćenja i odgovornosti policajca kako su definisane vaŹećim zakonima i članom 48 Zakona br. 04/L-076 za Policija postoje dve kategorije smrti policajskih sluŹbenika:</p> <p>1.1. Smrt policajca na duŹnosti i</p> <p>1.2. Smrt policajca prilikom obavljnja sluŹbene duŹnosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Vdekja e zyrtarit policor në detyrë</p> <p>1. Nënkupton vdekjen e zyrtarit policor i cili ka të themeluar marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës pavarësisht a është në vendin e punës apo jo.</p> <p>2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë rastet kur me rastin e vdekjes:</p> <p>2.1. Zyrtari policor është i involvuar në veprimtari kriminale nga veprimi direkt apo indirekt i tij;</p> <p>2.2. Në papërshtatshmëri në përputhje të kodit të etikës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Death of the police officer on duty</p> <p>1. Means the death of the police officer who has established working relations with the Kosovo Police, regardless if he is at his working place or not.</p> <p>2. Exceptionally from point 1 of the existing article, are cases when in the occasion of the death:</p> <p>2.1. Police officer is involved in criminal activities by his direct or indirect action;</p> <p>2.2. Is in inconsistency with code of ethics.</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Smrt policajca na duŹnosti</p> <p>1. Znači smrt policajca koji je osnivaov radni odnosu Kosovskoj Policiji nezavisno da li je na poslu ili ne.</p> <p>2. Osim stava 1. ovog člana su slucajevi gde prilikom smrti:</p> <p>2.1. Policajac koji je uključen u kriminalne aktivnosti od strane direktnog ili indirektnog njegovog delovanja;</p> <p>2.2. U skladu neadekvatnost etičkog kodeksa.</p>

<p>3. Kompensimi për vdekjen e zyrtarit policor në detyrë bëhet ashtu siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Vdekja e zyrtarit policor në kryerje të detyrës</p> <p>1. Zyrtari policor konsiderohet se vdes në kryerje të detyrës nga një akt kriminal, në operacionet policore apo aksident përgjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore derisa është në detyrë apo jashtë saj.</p> <p>2. Kompensimi për vdekjen e zyrtarit policor në kryerje të detyrës bëhet ashtu siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.</p>	<p>3. The compensation of the death of a police officer on duty is done as it is determined by article 48 of the Law on Police No.04/L-076.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Death of the police officer in the line of duty</p> <p>1. The police officer is considered that died in line of duty by a criminal act in police operations or accident during the performance of the duties and police authorizations while on or out off duty.</p> <p>2. The compensation of the death of a police officer in line of duty is done as it is determined by article 48 of the Law on Police No.04/L-076.</p>	<p>3. Naknada za smrt policajca koji je poginuo na dužnosti je, kako je definisano u članu 48 Zakona za Policiju br.04/L-076.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Smrt policajca prilikom obavljanja službene dužnosti</p> <p>1. Policijski službenik smatra se da je poginuo na dužnosti od krivičnog dela ili nesreće na radu policije u vršenju dužnosti i ovlašćenja policije dok su na dužnosti ili van nje.</p> <p>2. Naknada za smrt policajca koji je poginuo na dužnosti je kako je definisano u članu 48 Zakona za Policiju br.04/L-076.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Njoftimi për vdekjen e zyrtarit policor në detyrë apo në kryerje të detyrës</p> <p>1. Policia e Kosovës pas konstatimit të vdekjes së zyrtarit policor nga ana e personelit mjekësor obligohet që në radhë të parë të njoftoj familjen e zyrtarit policor i cili ka vdekur në detyrë apo në kryerje të detyrës.</p> <p>2. Njoftimi i anëtarëve të ngushtë të familjes duhet të bëhet sa më shpejtë që është e mundur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 The announcement of the death of a police officer on duty or in the line of duty</p> <p>1. After determining of the death of the police officer by medical personnel, Kosovo Police is obliged to first inform the family of the police officer who died on duty or in the line of duty.</p> <p>2. The notification of close family members must be done as soon as possible.</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Najava smrti policijskog službenika na dužnosti ili po službenoj dužnosti</p> <p>1. Kosovska policija nakon pronalaženja smrti policajca od strane medicinskog osoblja je dužan da prvo obavesti porodicu policajca koji je poginuo na dužnosti ili po službenoj dužnosti.</p> <p>2. Obaveštavanje članova uže porodice treba da se uradi što je pre moguće.</p>

<p>3. Emri i policit të ndjerë nuk duhet t'i jepet mjeteve të informimit apo ndokujt tjetër para se të jenë njoftuar anëtarët e familjes te të ndjerit.</p> <p style="text-align: center;">Nenin 8 Komisioni për përcaktimin e kategorisë së vdekjes së zyrtarit policor në detyrë apo në kryerje të detyrës</p> <p>1. Drejtori i Përgjithshëm formon një komision për përcaktimin e kategorisë së vdekjes së zyrtarit policor në detyrë apo në kryerje të detyrës (në tekstin e mëtejme komisioni);</p> <p>2. Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarësh të cilët duhet të jenë përfaqësues të Policisë e Kosovës, ku njëri nga anëtarët duhet të jetë nga zyra ligjore e Policisë së Kosovës.</p> <p>3. Komisioni bënë edhe vlerësimin nëse zyrtari policor i cili ka vdekur në detyrë apo në kryerje të detyrës ka qenë duke kryer detyrat dhe autorizimet e tij sipas legjislacionit përkatës në fuqi, apo ai ka qenë duke kryer veprime të kundërligjshme të cilat sanksionohen me legjislacion përkatës në fuqi.</p> <p>4. Drejtori i përgjithshëm nxjerr akt nënligjor me të cilin i përcakton dhe rregullon çështjet lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e ceremonialit të varrimit të zyrtarit policor të vdekur në detyrë apo</p>	<p>3. The name of the deceased police must not be given to media or to someone else, before being notified the family members of the deceased.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Commission for determination of the death category of the police officer on duty or in the line of duty</p> <p>1. The general director establishes a commission for determination of the category of the death of the police officer on duty or in the line of duty (here in after Commission);</p> <p>2. The Commission is made of three (3) members, who must be representatives of Kosovo Police, where one of the members should be from the legal office of Kosovo Police.</p> <p>3. The Commission makes an assessment whether the police officer, who died on duty or in the line of duty, has been performing its duties and authorizations as per respective legislation in force, or he was doing illegal acts that are sanctioned by respective legislation in force.</p> <p>4. General Director adopts a bylaw, by which he determines and regulates issues regarding the organization and conduct of the burial ceremony of the police officer who died on duty or in the line of duty.</p>	<p>3. Imena preminulih policija ne treba dati medijima ili bilo kome drugom pre nego što je obavestila članove porodice pokojnike.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Komisija za utvrđivanje kategorije smrti policijskog službenika na dužnosti ili po službenoj dužnosti</p> <p>1. Generalni direktor formira komisiju za utvrđivanje kategorije smrti policijskog službenika na dužnosti ili po službenoj dužnosti (u daljem tekstu:Komisija);</p> <p>2. Komisija se sastoji od tri (3) člana, koji će biti i predstavnici Kosovske policije, gde je jedan od članova mora biti iz pravne Kancelarija Kosovske Policije.</p> <p>3. Komisija daje ocenu da li je policajac koji je poginuo na dužnosti ili po službenoj dužnosti je obavljao svoje dužnosti sa ovlašćenjima u skladu sa zakonima na snazi, ili je on obavljao nezakonite radnje koje su sankcionisane zakonodavstvom na snazi.</p> <p>4. Generalni direktor izdaje podzakonski akt koji definiše i reguliše pitanja koja se odnose na organizaciju i sprovođenje svečane sahrane mrtvih policajca na dužnosti ili po službenoj dužnosti.</p>
--	--	--

<p>në kryerje të detyrës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Ankimimi</p> <p>1. Anëtarët e familjes së zyrtarit policor të vdekur në detyrë apo në kryerje të detyrues kanë të drejtë ankese brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit të Komisionit.</p> <p>2. Ankesa i parashtrohet zyrës për ankesa dhe shpërblime në Policinë e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Appeal</p> <p>1. Family members of the deceased police officer on duty or in the line of duty have the right to appeal within 15 days from the date when they receive the decision of the Commission.</p> <p>2. Appeal must be submitted to the Office for Appeals and Rewards on the Kosovo Police.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Žalba</p> <p>1. Članovi porodice preminulog policajca u vršenju dužnosti imaju pravo žalbe u roku od 15 dana od prijema rešenja pd strane komisije.</p> <p>2. Žalba se podnese Kancelariji za žalbe i nagrade u Kosovskoj Policiji.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Kompensimi</p> <p>1. Të gjithë zyrtarët policor të cilët kanë rënë në kryerje të detyrës apo ata të cilët kanë vdekur në detyrë sipas këtij udhëzimi administrativ që nga themelimi i Policisë së Kosovës gëzojnë të drejtat e kompensimit nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Të drejtë kompensimi kanë anëtarët e familjes së ngushtë derisa sipas llogarisë zyrtari apo zyrtarja policore ti ketë mbushur 65 vjeç.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Compensation</p> <p>1. All police officers who died on duty or those who died in the line of duty according to this administrative instruction, since the establishment of Kosovo Police have the rights for compensation, the moment when this Administrative Instruction enters in to force.</p> <p>2. The right for compensation have the close family members until as per calculations the police officer reaches 65 years old.</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Kompenzacija</p> <p>1. Svi oficiri koji su pali na dužnosti ili koji su poginuli u aktivnoj službi u okviru ovog Administrativnog Uputstva od osnivanja Policije Kosova imaju pravo na naknadu od dana stupanja na snagu ovog AU.</p> <p>2. Pravičnu naknadu imaju bliski članove porodice, a prema službenom nalogu ili policijski službenik/nica koji/koja je dostigao 65 godina.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Buxheti</p> <p>1. Kompensimi i zyrtarëve policor të rënë</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Budget</p> <p>1. The compensation of the deceased</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Budžet</p> <p>1. Naknada policajaca koji je poginuo na</p>

<p>në detyrë apo në kryerje të detyrës bëhet nga buxheti i Policisë së Kosovës, nga kategoria e subvencioneve</p> <p>2. Zbatimi i këtij udhëzimi administrativ mund të rishikohet nëse Qeveria e Kosovës ka vështirësi financiare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Shfuqizimi</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohen të gjitha aktet që kanë rregulluar këtë çështje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Kryeministrit.</p> <p style="text-align: right;">Hashim THAÇI</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: right;">Datë: 17.07.2013</p>	<p>police officer on duty or in the line of duty is done from the budget of Kosovo Police, from the category of subventions.</p> <p>2. Implementation of this administrative instruction may be reviewed if Government of Kosovo faces financial difficulties.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Abrogation</p> <p>With the entrance in to force of this Administrative instruction, all acts that have regulated this issue are abrogated.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Entry in to force</p> <p>This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after signature by the prime Minister.</p> <p style="text-align: right;">Hashim THAÇI</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Prime Minister of the Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: right;">Date: 17.07.2013</p>	<p>dužnosti ili po službenoj dužnosti se vrši iz budžeta Kosovske Policije, iz kategoriji subvencija.</p> <p>2. Sprovođenje ovog administrativnog uputstva može da se predgleda ukoliko Vlada Kosova ima finansijske poteškoće.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Ukidanje</p> <p>Stupanjem na snagu ovog administrativnog uputstva ukidaju se svi zakonski koji regulišu ovo pitanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana posle objavljivanja u Službenom Listu Republike Kosova.</p> <p style="text-align: right;">Hashim THAÇI</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/> <p style="text-align: right;">Premijer Republike Kosova</p> <p style="text-align: right;">Datum: 17.07.2013</p>
---	---	---